



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Iniciativa për Përfshirje Digjitale - Projekt Rajonal Udhëzime për Thirrje për Pjesëmarrje në Projekt

Numri i Referencës së Projektit: IPA III/2024/458-876

Afati i fundit për aplikim është deri më 04.04.2025 ora 17:00 CET

Iniciativa për Përfshirje Digjitale (DII) – Projekt Rajonal i financuar nga Komisioni Evropian sipas Kontratës së Grantit IPA III/2024/458-876 shpall
Thirrje Publike për Aplikime për Përzgjedhjen e një Organizate me bazë në komunitet për përpjekje bashkëpunuese për avokim

Sfondi

Iniciativa për Përfshirje Digjitale - Projekti DII, i financuar nga Komisioni Evropian, zbatohet nga konsorciumi i organizatave: Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) nga Kosova, Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile (CSDC) nga Shqipëria, proMENTE - Hulumtime sociale nga Bosnja dhe Hercegovina, Qendra për Iniciativa Arsimore Hap pas Hapi nga Bosnja dhe Hercegovina, Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (MCEC) nga Maqedonia e Veriut dhe Qendra për Politika Arsimore (CEP) nga Serbia.

Projekti DII përqendrohet në fuqizimin e roleve dhe kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile (OShC), promovimin e zhvillimit dhe avokimin për politika gjithëpërfshirëse. Projekti DII synon krijimin e një mjedisi ku gjithëpërfshirja digjitale luan rol kyç në forcimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe në procesin e përafrimit me BE-në në rajonin e synuar. Njëpërmjet fokusit të përfshirja digjitale, projekti adreson një aspekt thelbësor të demokracisë moderne – garantimin e qasjes së barabartë në mjetet dhe informacionin digjital. Kjo është jetike për pjesëmarrjen e informuar të qytetarëve dhe angazhimin e tyre në proceset demokratike, duke kontribuar gjithashtu në procesin e përafrimit me BE-në. Objektivi specifik i projektit është **forcimi i kapaciteteve të OShC-ve dhe mundësive për angazhim në hartim të politikave dhe në vendimmarrje.**

1



MACEDONIAN
CIVIC
EDUCATION
CENTER





Financuar nga
Bashkimi Evropian



Iniciativa krijon sinergji me përpjekjet nacionale për përmirësimin e infrastrukturës digjitale, qeverisjes elektronike dhe qasjes brezgjere, duke avokuar për politika gjithëpërfshirëse, rritur njohuritë digjitale dhe nxitur angazhimin e komunitetit.

Në mënyrë që të përmbushen objektivat dhe synimet e projektit, **do të përzgjidhet një organizatë me bazë në komunitet, në Kosovë.** E integruar brenda komuniteteve, kjo organizatë duhet të ndërveprojë drejtpërdrejt me grupet e marginalizuara dhe të jetë e lidhur mirë me komunitetet lokale. Organizata me bazë në komunitet, e udhëzuar nga organizata kontraktuese, do të duhet të identifikojë një komunitet të marginalizuar brenda rajonit të vet. Këto komunitete do të përzgjidhen bazuar në sfidat e tyre specifike që lidhen me përfshirjen digjitale ku pabarazitë në qasjen në mjetet dhe shërbimet digjitale janë më të theksuara. Hartimi i ndërhyrjeve të synuara lokale është i strukturuar në tre faza: zhvillimi i një vlerësimi të detajuar të nevojave, planifikimi i detajuar i strategjive të ndërhyrjes dhe sigurimi i aprovimeve të nevojshme për të siguruar përputhshmërinë. Konsorciumi synon të rrisë kapacitetet e organizatës me bazë në komunitetin për mbështetje të përfshirjes digjitale për grupet e marginalizuara përmes mentorimit, pjesëmarrjes aktive në zhvillimin e politikave dhe avokimit, si dhe përmes angazhimit në aktivitetet e rrjetëzimit në nivel vendi dhe rajonal. Organizata pritet të bashkëpunojë nga afër me anëtarin e Konsorciumit në vendin e tyre përkatës (organizatën kontraktuese) gjatë të gjitha fazave të intervenimit dhe të ndërveprojë si një njësi e fuqishme për avokim për zbatimin dhe integrimin e politikave dhe praktikave të rekomanduara për përfshirje digjitale. **Intervenimet dhe aktivitetet lokale do të përcaktohen më tej së bashku me anëtarin përkatës të konsorciumit pas përzgjedhjes së organizatës me bazë në komunitet. Në fazën e aplikimit, organizata duhet të demonstrojë kapacitetin e vet, interesin dhe të përshkruajë intervenimet e mundshme.**

Qëllimi i Thirrjes

Qëllimi kryesor i Thirrjes: Të zhvillohen kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile që të jenë akterë efektivë dhe të përgjegjshëm, të aftë për angazhim konstruktiv me palët relevante të interesit në çështjet e përfshirjes digjitale.

Qëllimi specifik i Thirrjes: Të fuqizohen organizatat me bazë në komunitet për të adresuar sfidat e përfshirjes digjitale për grupet e marginalizuara përmes aktiviteteve që synojnë të përmirësojnë integrimin e tyre në jetën e komunitetit dhe të rrisin vetëdijësimin e palëve të interesit në lidhje me barrierat dhe mundësitë për përfshirje digjitale.

2



MACEDONIAN
CIVIC
EDUCATION
CENTER





Financuar nga
Bashkimi Evropian



Grupet e synuara

Fokusi parësor i përpjekjeve për përfshirjen digjitale vihet veçanërisht tek gratë dhe të rinjtë në komunitetet e margjinalizuara. Këto grupe kanë nevojë për qasje në mjete digjitale, lidhshmëri dhe trajnime për shkathtësi digjitale për t'i kapërcyer barrierat socio-ekonomike, izolimin gjeografik dhe faktorët kulturorë.

Për të promovuar pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e barabartë inkurajohet përfshirja e grupeve të ndryshme të margjinalizuara, duke përfshirë gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, minoritetet (ose komunitetet pakicë) dhe personat më të pafavorizuar ekonomikisht.

Rezultatet e pritura të Thirrjes

- Forcimi i kapaciteteve të organizatave me bazë në komunitet për të avokuar dhe zbatuar iniciativa për përfshirje digjitale.
- Prezantimi i praktikave të reja për promovimin e përfshirjes digjitale brenda mjediseve të komunitetit.

Periudha e zbatimit

Kohëzgjatja e projektit është 24 muaj.

Zbatimi i intervenimeve lokale që do të ofrohen nga organizata e përzgjedhur me bazë në komunitet, planifikohet për vitin e dytë të projektit DII, pra nga janari 2026.

Përgjegjësitë e organizatës me bazë në komunitet

Nga organizata me bazë në komunitet pritet që:

- Të jetë pjesë e koalicionit kombëtar të dedikuar për përfshirjen digjitale. Aktivitetet e koalicionit do të përfshijnë të paktën 5 ngjarje;
- Të marrë pjesë aktive në shkollën verore që do të mbahet në një nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Një komponent qendror i shkollës verore do të përqendrohet në trajnimin e pjesëmarrësve për planifikimin dhe zbatimin efektiv të ndërhyrjeve lokale;
- Të marrë pjesë në punëtorinë rajonale për mësim dhe ndarje eksperiencash me grupe të ngjashme;
- Të marrë pjesë në tre sesione mësimi virtual;
- Të zhvillojë vlerësim të nevojave lokale për të identifikuar barrierat digjitale me të cilat përballen grupet e margjinalizuara;
- Të dizajnojnë planin e detajuar të intervenimit për intervenimin lokal për një kohëzgjatje prej 12 deri në 14 muaj (plani i intervenimit do të dizajnohet bashkërisht nga organizata me bazë në komunitet dhe anëtari përkatës i konsorciumit);
- Të zbatojë planin për intervenim lokal, i planifikuar që të zgjasë ndërmjet 12 dhe 14 muajve;
- Të përgatisë raportet e nevojshme narrative dhe financiare siç kërkohet nga Konsorciumi.

3



MACEDONIAN
CIVIC
EDUCATION
CENTER





Financuar nga
Bashkimi Evropian



Detajet e financimit

Vlera maksimale e grantit është 52,000 EUR.

Nga vlera totale e grantit prej 52,000 EUR, aplikantët duhet të rezervojnë 15% për ngritjen e kapaciteteve dhe të paktën 20,000 euro për intervenimin lokale.

Financimi i grantit do t'i nënshtrohet raportimit për grante të BE-së, **duke përfshirë kërkesat dhe afatet kryesore të BE-së, sipas udhëzuesit praktik për procedurat e kontratës për veprimet e jashtme të Bashkimit Evropian (PRAG).**

Fushat e interesit

Me këtë thirrje synohet të mbështeten organizatat lokale me bazë në komunitet që tregojnë aftësi dhe vullnet për t'u përfshirë në një ose më shumë nga aktivitetet e mëposhtme ose iniciativa të ngjashme:

- Fushata vetëdijesimi që synojnë palët e interesit dhe politikëbërësit lokalë për të zhvilluar politika digjitale gjithëpërfshirëse, duke theksuar përfitimet dhe rreziqet e angazhimit digjital.
- Projekte të bazuara në komunitet për të lehtësuar qasjen në mjetet dhe burimet digjitale, duke përfshirë organizimin e punëtorive për edukimin digjital për të përmirësuar shkathtësitë e pjesëtarëve të komunitetit, si dhe organizimin e punëtorive për dizajnim gjithëpërfshirës për të siguruar që zgjidhjet digjitale t'u shërbejnë të gjithë pjesëtarëve të komunitetit.
- Dokumentimi dhe shpërndarja e praktikave të mira për gjithëpërfshirjen digjitale, duke mundësuar krijimin e përmbajtjes digjitale lokale si blogje komunitare ose tregje online.
- Ndarja e përvojave dhe rrjetëzimi me OShC-të e tjera që punojnë në fushën e përfshirjes digjitale, duke përfshirë shkëmbimin e përvojave në zbatimin e mjeteve dhe strategjive digjitale.
- Aktivitete për ngritje të kapaciteteve të fokusuara në planifikimin strategjik, mbledhjen e fondeve dhe angazhimin e komunitetit, të shoqëruara me mbështetje teknike dhe programe mentorimi për t'i udhëzuar individët nëpërmjet sfidave digjitale.
- Iniciativa të bazuara në shkollë si klubet digjitale për të nxitur interesin e të rinjve për teknologjinë dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen e tyre aktive në komunitetin digjital.
- Sfida të ndërmarrësisë për të frymëzuar inovacionin dhe për të adresuar çështjet lokale, me synimin për të rritur ndikimin ekonomik dhe social të përpjekjeve për përfshirje digjitale



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Llojet e intervenimeve

Shembuj të intervenimeve lokale përfshijnë organizimin e punëtorive për edukim digjital për të përmirësuar shkathtësitë e anëtarëve të komunitetit, lehtësimin e krijimit të përmbajtjes digjitale lokale si blogjet e komunitetit apo tregje online, ofrimin e programeve për mbështetje teknike dhe programe mentorimi për t'i udhëzuar individët nëpërmjet sfidave digjitale, inicimin e klubeve digjitale me bazë në shkollë për të nxitur interesin e të rinjve për teknologjinë, zhvillimin e fushatave të vetëdijesimit për përfitimet dhe rreziqet e përfshirjes digjitale, organizimin e punëtorive për dizajnim gjithëpërfshirës për të siguruar që zgjidhjet digjitale t'u shërbejnë të gjithë anëtarëve të komunitetit, zbatimin e sfidave të ndërmarrësisë për të frymëzuar inovacionin dhe adresimin e çështjeve lokale, dhe të tjera iniciativa të ngjashme

Plani i intervenimit do të hartohet bashkërisht nga organizata e bazuar në komunitet dhe anëtarët e saj, bazuar në analizën e detajuar të nevojave.

Roli i Konsorciumit

Konsorciumi do të zhvillojë gjithashtu një paketë mentorimi për të specifikuar mbështetjen e ofruar nga partnerët e projektit dhe do të organizojë një seri ngjarjesh për zhvillimin e kapaciteteve për të përmirësuar aftësitë e organizatave të përzgjedhura (si: shkolla verore, iniciativë e vazhdueshme për shkëmbim njohurish (punëtori të mësimin nga njëri-tjetri, seanca mësimore virtuale, ndarje të praktikave më të mira, sesione reflektimi dhe arkiv të burimeve).

Vlerësimi dhe përzgjedhja e organizatës

Procesi i përzgjedhjes

Përzgjedhja e aplikantëve është proces i organizuar në dy faza: përzgjedhja paraprake fillestare (Përfshinë një kontroll administrativ dhe të përshtatshmërisë së dokumenteve të aplikimit) dhe vlerësimi. Të gjitha aplikimet do të vlerësohen fillimisht për t'u siguruar që i plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe kriteret e përshtatshmërisë, si më poshtë:

5



MACEDONIAN
CIVIC
EDUCATION
CENTER





Kriteret përshtatshëm për aplikantët:

- Duhet të jetë një organizatë joqeveritare e themeluar dhe e regjistruar në Kosovë; (Preferohet organizatë me bazë në komunitet që nuk është e vendosur në kryeqytet dhe/ose që punon në zona rurale).
- Duhet të ketë të paktën një vit përvojë pune me komunitetet lokale.
- Duhet të demonstrojë aftësi për të adresuar sfidat e përfshirjes digjitale brenda komunitetit lokal dhe të angazhohet në avokim efektiv.

Procesi i përzgjedhjes është planifikuar të finalizohet brenda muajit prill 2025

Procesi i vlerësimit

Vlerësimi si pjesë e procesit të përzgjedhjes do të vlerësojë aplikantët në bazë të kriterëve të listuara në tabelën e mëposhtme, për të siguruar aftësinë e tyre për të kontribuar në mënyrë efektive në përpjekjet për përfshirjen digjitale. Çdo kriter vlerëson aspekte të ndryshme të përvojës, kapacitetit dhe qasjes strategjike të organizatës. Aplikantët do të vlerësohen në bazë të përvojës së demonstruar, qasjes strategjike dhe mundësisë për ndikim të rëndësishëm në avancimin e përfshirjes digjitale në komunitetet lokale. Përshkrime më të detajuara të kriterëve të vlerësimit jepen në tabelën më poshtë.

Tabela e vlerësimit për përzgjedhjen e organizatave në nivel bazë

Kriteret	Rezultati maksimal	Shpjegimi
1. Pajtueshmëria Administrative	Kalon/Nuk kalon	Kërkesat bazike administrative: 1. Formulari i kompletuar i aplikimit, 2. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së, 3. Raportet financiare për 3 vitet e fundit (dorëzimi i këtyre dokumenteve është i detyrueshëm; nëse organizata nuk disponon dokumente të tilla, duhet të japë një deklaratë që tregon arsyet pse);
2. Përvoja me komunitetet lokale	10	Vlerëson historikun e organizatës në punën me grupet e marginalizuara dhe angazhimin me komunitetet lokale. 1. Pak ose aspak përvojë (0-1 pikë) 2. Përvojë e kufizuar, disa rezultate të dukshme (2-4 pikë) 3. Përvojë me disa grupe të marginalizuara, disa rezultate pozitive (5-7 pikë)



Kriteret	Rezultati maksimal	Shpjegimi
		4. Përvojë e gjerë me grupe të shumta të marginalizuara, rezultate pozitive të dukshme (8-10 pikë)
3. Të kuptuarit e nevojave për përfshirje digjitale të komunitetit lokal dhe avokimi	10	Vlerëson kapacitetin e dëshmuar të aplikantit për të adresuar sfidat e përfshirjes digjitale brenda komunitetit lokal dhe angazhimin në avokim efektiv. 1. Pak ose aspak përfshirje të mëparshme në përfshirje digjitale ose avokim, pa një kuptim të qartë të sfidave.(0-1 pikë) 2. Ekzistojnë disa përpjekje të përfshirjes digjitale ose avokimit në shkallë të vogël, por ato janë të kufizuara në ndikim, shtrirje dhe qasje strategjike (2-4 pikë) 3. Historik të dëshmuar të të iniciativave për përfshirje digjitale me ndikim të matshëm në komunitet, angazhim të palëve të interesit dhe qëndrueshmëri të moderuar (5-7 pikë) 4. Përvojë e gjerë në përfshirjen digjitale me iniciativa të dëshmuara dhe të qëndrueshme, ndikim të fortë të palëve të interesit dhe ndikim afatgjatë strategjik (8-10 pikë).
4. Rrjetëzimi dhe bashkëpunimi	5	Vlerëson aftësinë e aplikantit për të bashkëpunuar me OSHC-të tjera, palë të interesit vendor/rajonale dhe rrjetet. 1. Nuk ka përvojë të mëparshme pune me OSHC, palë të interesit ose rrjetet, pa dëshmi të partneriteteve ose iniciativave të përbashkëta (0 pikë) 2. Pak përvojë në angazhimin me organizata ose palë të tjera të interesit (1-2 pikë) 3. Ka përvojë në punën me OSHC dhe palë të interesit përmes bashkëpunimeve të strukturuar, iniciativave të përbashkëta ose pjesëmarrjes në rrjete me kontribute të matshme (3-4 pikë) 4. Pjesëmarrje aktive në rrjetet vendore/rajonale, drejton ose bashkëdrejton iniciativa me OSHC dhe palë të interesit me qasje partneriteti afatgjatë (5 pikë).
Rezultati total maksimal	25	



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Dokumentet e aplikimit

Aplikimet e plota janë ato që përfshijnë:

1. Formularin e Aplikimit (Aneksi 1);
2. Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së;
3. Raportet financiare për 3 vitet e fundit (dorëzimi i këtyre dokumenteve është i detyrueshëm; nëse organizata nuk disponon dokumente të tilla, duhet të sigurojë një deklaratë që tregon arsyet pse);
4. CV-të profesionale të anëtarëve kyç të stafit. (maksimumi dy faqe për secilën biografi).

Numri i aplikimeve dhe granteve për një aplikant.

Aplikantët nuk mund të dorëzojnë më shumë se një (1) aplikim për këtë thirrje për propozime.

Dorëzimi i aplikimit

Aplikimet e plotësuara duhet të dorëzohen në format elektronik, si dokumente word-i dhe pdf-i, me email në: grants@kec-ks.org me titullin: **DII - Dorëzimi i Aplikimit – Emri i Aplikantit.**

Çdo pyetje në lidhje me thirrjen mund të dërgohet në email-in e mëposhtëm: grants@kec-ks.org me referencën e mëposhtme:

Pyetje në lidhje me thirrjen për Aplikime për Përzgjedhjen e Organizatës me Bazë në Komunitet për përpjekje bashkëpunuese për avokim, jo më vonë se 28.03.2025, deri në orën 17:00 (CET).

AFATI PËR DORËZIM TË APLIKIMIT ËSHTË 04.04.2025, ora 17:00 (CET).

APLIKIMET E PRANUARA PAS KËTIJ AFATI NUK DO TË SHQYRTOHEN.